

VENDIM
Nr. 467, datë 22.5.2013

PËR KALIMIN NË PRONËSI, PA SHPËRBLIM, TE KOMUNITETI MYSLIMAN, PËR MYFTININË ELBASAN, TË SIPËRFAQES 5902 M², NGA TRUALLI I PRONËS NR. 278, ME EMËRTIM “REPARTI USHTARAK NR. 5012/31”, ME VENDNDODHJE NË ZARANIKË, ELBASAN, NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË MBROJTJES DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 4, shkronja “a” të ligjit nr. 7980, datë 27.7.1995 “Për shitblerjen e trojeve”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi, pa shpërblim, te Komuniteti Mysliman, për Myftininë Elbasan, të sipërfaqes së lirë prej 5902 m², pjesë e pronës nr. 278, me emërtim “Reparti ushtarak nr. 5012/31”, me vendndodhje në Zaranikë, Elbasan, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, për t’u përdorur për nevoja të Myftinisë Elbasan, sipas planvendosjes që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Sipërfaqja 5902 (pesë mijë e nëntëqind e dy) m², pjesë e pronës nr. 278, me emërtim “Reparti ushtarak nr. 5012/31”, me vendndodhje në Zaranikë, Elbasan, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.

3. Komunitetit Mysliman dhe Myftinisë Elbasan u ndalohet tjetërsimi i pronësisë së sipërfaqes 5902 (pesë mijë e nëntëqind e dy) m², pjesë e pronës nr. 278, me emërtim “Reparti ushtarak nr. 5012/31”, me vendndodhje në Zaranikë, Elbasan, të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Myftinia Elbasan, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave të Paluajtshme dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha